



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:049916

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06789487

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.131/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË–DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi- Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit F.B nga Pejë, për shkak të veprës penale “Falsifikimi i dokumentit” nga neni 390 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore ne Peje-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.717/24 të dt.24.05.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datën 20.01.2025, ne prezencën e prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit F.B, mbrojtësit të tij, av. Rrustem Lajqi nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 23.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 31.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F.B, i lindur me datë, në fshatin, Komuna e Deçanit, me banim në fshatin në rr. “.....”, nr. ..., nga i ati I., nëna A., e gjinisë, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i fëmijëve, i pa punë, posedon tel me nr....., i identifikuar sipas numrit personal të letërnjoftimit i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt. 10.11.2022, në Stacionin Policor Pejë, me dije përdor dokumentin e falsifikuar, me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në vendin e lartcekur ku paraqet kërkesë për tu pajisur me një dokument për leje të armës së humbur në emër të vëllait të tij, me ç’ rast zyrtarëve policor ju prezanton letërnjoftimin në të cilin vërehej fotografia e të pandehurit ndërsa të dhënat personale të vëllait të tij XH.B, i cili letërnjoftim pas ekzaminimit nga Agjensioni i Forenzikës, devizioni për traseologji forenzike, laboratorit i dokumenteve dhe dorëshkrimeve në Prishtinë, rezulton të jetë falsifikim i plotë,

-Me çka ka kryer veprën penale **“Falsifikimi i dokumentit”** nga neni 390 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72 dhe 390 par.2 dhe 1 të KPRK-së, dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej dymijë e pesëqind (2500) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tre (3) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Si dhe me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumën prej njëzetë (20) euro për një (1) ditë burgimi.
- IV. **OBLIGOHEN** të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, secili veç e veç të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe shumën prej njëzetë (20) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- V. Konform nenit 276 par. 1 KPPRK-së, **KONFISKOHET** në mënyrë të përhershme dokumenti i falsifikuar: Letërnjoftimit me numër ,,,,,,,,,, në emër të XH.B, të sekuestruara sipas vërtetimit mbi sekuestrim të përkohshëm të sendeve të dt.10.11.2022, dhe **URDHËROHET** Policia e Kosovës, të bëjë shkatërrimin e tij pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, sipas procedurave standarde ligjore në fuqi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 24.05.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.717/24 ndaj të pandehurit F.B nga Pejë, për shkak të veprës penale **“Falsifikimi i dokumentit”** nga neni 390 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 20.01.2025, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri F.B, mbrojtësi i tij, av.Rrustem Lajqi nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP/II.nr.717/24 të dt.24.05.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri F.B, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë të njëjti i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me ç'rast i njëjti me vullnet e vetëdije të plotë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Pas deklarimit të të pandehurit gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, kështu Prokurori i Shtetit ka deklaruar *se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është pajtuar edhe mbrojtësi i të pandehurit, av. Rrustem Lajqi i cili ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, është bërë në konsultim me mua si mbrojtjes, është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe kërkoj nga gjykata që të njëjti ti aprovohet*.

Në vijim, gjykata pasi ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe deklarimet e palëve në procedurë e në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti se në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin se gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, së një pranimi i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe së pranimi i fajësisë nga i pandehuri po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i policit S.K. 10.11.2022, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të pandehurin në Stacion Policor dt. 25.07.2022, Lista e dëshmitëve, Raport mbi deklarimin e humbjes së dokumenteve, Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, Raport i ekspertimit dt.27.10.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje të pandehurin në procedurë paraprake, i dt.15.02.2024*, po ashtu, gjykata ka gjetur se aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që të mirët parasysh ndonjë dënim i mëparshëm eventual ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë*.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Rrustem Lajqi, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që pranimi i fajësisë të mirët si rrethanë lehtësuese, faktin që është mbajtes i familjes gjashtë anëtarësh,*

gjendjen e tij të dobët ekonomike, kërkoj nga gjykata që këto rrethana ti marrë si rrethana lehtësuese në mënyrë që të pandehurit ti shqiptohet një dënim sa me i butë.

I pandehuri F.B, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tilla, shpreh keqardhje.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Falsifikimi i dokumentit*” nga neni 390 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje, është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer dhe premtimin që i njëjti në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla, faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, ndërkaq rrethana rënduese përveç elementeve të veprës penale për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me kusht u mor në përputhje me nenin 48 par.1 dhe 2, e lidhur me nenin 49 par.1, dhe par.4 të KPRK-së, e po ashtu me nenin 390 paragrafi.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas të cilit është parashikuar se formën themelore të veprës penale ku sipas par.1 parashihet se: “*Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.*” Ndërsa me paragrafin 2, parashihet që: “*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistr tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.*”

Ndërkaq, në dispozitën par.1 të nenit 49 të KPRK-së, që i referohet kushteve mbi shqiptimit e dënimit me kusht përcaktohet se: *“Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”*, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: *“Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”*.

Ndërsa sipas par.5 të nenit 49 të KPRK-së, i cili përcakton se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim”*, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht vetëm sa i përket dënimit me burgim. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej 2 vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që i njëjtit të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, është marrë konform nenit 50 par.2 të KPRK-së, andaj ka vendosur si në pikën e III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën e IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata sipas detyrës zyrtare e mori duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 të KPRK-së, dhe ka urdhëruar konfiskimin e letërnjoftimit me numër 13514112 në emër të XH.B, si dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, do të behët shkatërrimi i tij sipas procedurave standarde ligjore.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.131/24, me datë 31.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajçi-Muçaj

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.